



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Në bazë të nenit 9 të Rregullores mbi punën e Komisionit Arbitrar dhe Ankesës, Nr.215 të dt.08.06.2015, Komisioni Arbitrar në përbërje, Halit Muharremi-Kryetar (mungon), Asdren Hoxha dhe Artan Qerkini-Anëtare, me shumicë të votave (2:1) në mbledhjen e mbajtur me dt.10.06.2015 dhe 15.06.2015 mori këtë:

V E N D I M

- A. Mbetet në fuqi, dënimi me gjobë në shumë prej 2.000,00 Euro.
- B. Refuzohet Ankesa e KB Peja që ka të bëjë me anulimin e ndeshjeve 2:1 për KB Sigal Prishtina
- C. Refuzohet ankesa e KB "Peja" që ka të bëjë me përjashtimin nga Superliga dhe kalimin në një rang më të ulët të garave,
- D. Aprovohet pjesërisht ankesa e KB "Peja" në lidhje me kohëzgjatjen e pezullimit të z. Gazmend Pupovci, ndërsa i lartëcekuri dënohet me ndalesë kohore për kryerje të detyrës në kohëzgjatje prej (6) muajve, nga dita e marrjes së këtij Vendimi.

A R S Y E T I M

Fillimisht, Komisioni Arbitrar, analizoi, afatshmerin e Ankesës së shqyrtuar edhe konstatoi se e njehta është ushtruar brenda afatit të përcaktuar me rregulloret në fuqi.

Pretendimet ankimore të KB "PEJA" mund të përmbliidhen si në vijim :

1. Është shkelur Neni 20 i rregullave zyrtare të lojës së basketbollit FIBA ;
2. FBK duhet të zbatojë rregullat zyrtare të lojës të aprovuara nga FIBA ;
3. Komisioni Disciplinorë nuk ka marrë parasysh rrethanat e krijuara në fushën e lojës ;
4. Ka kundërthënë në mes të deklaratave të arbitrit të ndeshjes, delegatit të ndeshjes dhe stacionit policorë në lidhje me faktin se kur ka filluar të matet koha për kthimin e ekipit në fushë;
5. Komisioni disiplinorë nuk ka përfillur sygjerimet e Komisionit Arbitrar ;
6. Nuk është marrë si rrethanë lehtësuese deklarata e sekretarit gjeneral të KB "PEJA" .

Komisioni për Arbitrazh do të shqyrtojë të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga KB "Peja".

1. Neni 20 i rregullave zyrtare të lojës përcakton pasojat për dorëzimin e lojës (ndeshjës) , me ç'rast përcaktohet se ekipi do të humbas ndeshjën nëse :

- Ekipi nuk është i pranishëm ose nuk është në gjendje të fusë në fushën e lojës 5 lojtarë të gatshëm për të luajtur brenda 15 minutave, pas kohës së planifikuar për të filluar.
- Nëse veprimet e ekipës parandalojnë lojën e cila është duke u zhvilluar.
- Ekipa nuk pranon të luajë, pasi udhëzohet për ta bërë këtë nga arbitri.

Më tutje përcaktohen pasojat për ekipin që bënë njëren nga shkeljet e listuara si më lartë.

Por, shkeljet eventuale të nenit 20 të rregullave të lojës është dashur të atakohen me ankesë ndaj vendimit të Komesarit të Garave për regjistrimin e ndeshjës së serisë finale për edicionin garues 2014/2015 KB "Sigal-Prishtina" – KB "Peja" , sepse regjistrimi i lojës me rezultat zyrtarë dhe pasojat tjera juridike të këtij regjistrimi nuk kanë qenë objekt i vendim-marrjës nga ana e Komisionit Disciplinorë. Prandaj, Komisioni Arbitrar konsideron se pretendimi ankimorë që ka të bëjë me mos-zbatimin e nenit 20 të rregullave zyrtare të lojës së basketbollit (FIBA) është jolëndorë. Në bazë të nenit 27 të Rregullorës për Garat, KB "Peja" ka pasur mundësi që Vendimin e Komesarit të Garave për regjistrimin e ndeshjës ta atakojë me ankesë e cila është dashur t'i drejtohet Komisionit për Arbitrazh të FBK-së. Një veprim të tillë KB "Peja" nuk e ka ndërmarrë.

Neni 20.2.3 i Rregullave të FIBA-s përcakton pasojat e tëheqjës nga turnet e jo nga garat zyrtare të federatave nacionale. Për më shumë ky nen përcakton s'kualifikimin nga turneu dhe fatin e të gjitha ndeshjeve që i ka zhvilluar ekipi që tërhiqet duke përcaktuar se të gjitha ndeshjet e zhvilluara me këtë ekip do të jenë të pavlefshme. Përmbajtje po thujse identike me nenin 20 të rregullave të FIBA-s kanë edhe nenet 38 dhe 39 të Rregullorës së Garave të FBK-së :

Neni 38

Skuadra e cila pa arsye e braktisë fushën e lojës në pjesën e rregullt të garave e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 0:20 dhe i takon zero (0) pikë.

Neni 39

Në rastet e përsëritura të shkeljeve nga nenet 35, 36, 37 dhe **38** skuadra automatikisht largohet nga garat e mëtutjeshme dhe bie në një rang më të ulët të garave.

Jo rastësisht u tha më lartë "po thujase identike" , sepse Rregullorja e FBK-së e parashehë përveq largimit nga garat e mëtutjeshme edhe diskualifikimin si masë disiplinore. FIBA nuk ka parashikuar si sanksion rënien në një rang më të ulët të garave por një gjë të tillë e parashehë neni 1 i Propozicioneve të Garave dhe neni 40 i Rregullorës për Garat të FBK-së. Nuk mund të pranohet pretendimi se aktet normative të FBK-së janë në kundërshtim me ato të FIBA, sepse neni 20.2.3 rregullon vetëm qështjen që ka të bëjë me "tërheqjen për here të dytë" e jo edhe qështjen që ka të bëjë me tërheqjen nga ndeshja e play-offit. Në mbështetje të argumentit si më sipër dëshirojmë të potencojmë se edhe Rregullorja për

Garat e Federatës Kroate të Basketbollit¹ (Federatë e pranuar në FIBA qysh nga viti 1992) në nenin 56 të saj përcakton se klubi i cili braktisë fushën para përfundimit të ndeshjes bie në një rang më të ulët të garave. Pra, Federata Kroate e Basketbollit shkon edhe një hap më tutje duke përjashtuar klubin që braktisë ndeshjen zyrtare (jo në play-off) me kalimin në një rang më të ulët të garave. Edhe ky shembull tregon se politikën e basketbollit duke përfshirë edhe politikën ndëshkimore e bëjnë organet më të lartë të FBK-së siq janë Kuvendi dhe Bordi, ndërsa nuk është në misionin e Komisioneve të FBK-së që të deklarohen në lidhje me politikën ndëshkimore të FBK-së dhe politikat tjera për zhvillimin e basketbollit në Kosovë.

Ekziston një parim juridik imperative se e qarta nuk interpretohet, por zbatohet ashtu siq është. Neni 1 i propozicioneve të Garave dhe neni 40 i Rregullorës për Garat përcaktojnë qartë pasojat që mund t'i vuaj një klubë nëse braktisë ndeshjen e play-offit.

Neni 16 para 6 i Rregullorës Disciplinore të FBK-së pasheh mundësinë që kryësit ti shqiptohet denimi "përjashtim nga garat e mëtutjeshme ose kthim në rang më të ulët". Rregullorja disiplinore jep mundësi alternative për shqiptimin e dënimit ndaj një shkelësi të akteve normative, por me Propozicionet e garave dhe Rregullorën për garat është precizuar në mënyrë taksative se klubi që braktisë fushën e ndeshjes në garat e play-offit përjashtohet nga garat dhe bie në një rang më të ulët garues, nga ai që ka qenë në kohën e braktisjes së ndeshjes. Vlenë po ashtu të potencohet se në hierarkinë e akteve normative Rregullorja e Garave e mbizotronë Rregulloren Disciplinore, sepse kjo e para është nxjerrë nga Kuvendi i FBK-së si organi më i lartë i FBK-së, ndërsa e dyta nga Bordi i FBK-së.

2. FBK duhet të zbatojë rregullat zyrtare të lojës të aprovuara nga FIBA

FBK padyshim duhet të zbatojë rregullat zyrtare të aprovuara nga FIBA, por në asnjë rrethanë FBK nuk humbë autonominë e veprimit që në përputhje me rrethanat të imponojë politika ndëshkimore për shkeljet disiplinore që mund ti kryejn anëtarët e saj.

3. Komisioni Disciplinorë nuk ka marrë parasysh rrethanat e krijuara në fushën e lojës.

Pretendimi ankimorë në fjalë është i pabazuar, sepse nga Vendimi i Komisionit Disciplinorë vërehet qartë se ky komision ka marrë parasysh të gjitha rrethanat e krijuara duke cituar deklaratat e zyrtarëve të ndeshjes dhe duke u mbështetur në shkresat që gjenden në dosjen e lëndës, në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale. KB "Peja" pretendon se Komisioni Disciplinorë është dashur të merret me situatën e përgjithshme të krijuar në terren ku pretendohet se ka pasur ofendime dhe provokime nga tifozët e "Sigal-Prishtinës" në drejtim të zyrtarëve të klubit nga Peja. Për fat të keq ofendimet dhe sharjet drejtuar ndaj zyrtarëve të klubeve kosovare janë bërë përditshmëri e shëmtuar e basketbollit kosovar, por se a ka kushte për të vazhduar ndeshja apo jo vendosin zyrtarët e ndeshjeve (referi i parë) e jo zyrtarët e klubeve.

¹ . Komisioni për Arbitrazh nuk e mbështet vendimin e tij në Rregulloren për Garat të Federatës së Basketbollit të Kroacisë, por e përmend Rregulloren në fjalë vetëm për qëllime ilustrative në realacion të interpretimit të nenit 20.2.3 të Rregullave të Lojës të aprovuara nga FIBA.



4. Ka kundërthënë në mes të deklaratave të gjyqtarit të ndeshjes, delegatit të ndeshjes dhe stacionit policorë në lidhje me faktin se kur ka filluar të matet koha për kthimin e ekipit në fushë.

Fillimisht duke analizuar këtë pretendim ankimorë, Komisioni vërron se stacioni policorë përkatësisht zyrtarët policorë nuk janë kompetent të deklarohen në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me faktet e rëndësishme për ndeshjen siç është semafori, përkatësisht matja e kohës për kthimin e ekipit në fushë.

Deklaratat e Delegatit dhe Referit të parë janë në tërësi në harmoni me njëra tjetrën .

Delegati i ndeshjes kishte deklaruar “ Pas pritjes prej 15 minuta dha pak kohës shtesë ekipit të Pejës i është tërheqë vërejtja se brenda 5 minutave nëse nuk paraqiten në fushën e lojës Referit do ta përfundojnë ndeshjen “.

Referi i parë i ndeshjes kishte deklaruar “ Unë si pjesmarrës i ndeshjes nuk jam ndier i kërcnuar dhe nuk kamë parë se dikush mu ka kërcënuar as mua e as lojtarëve dhe trenerëve të KB Peja dhe pas bisedës me Policinë kam vlerësuar se ndeshja mund të luhet. Këtë ja kamë thënë dhe ja u kamë lënë në dispozicion 5 minuta që të kthehen në fushë pas kalimit të të cilave kam ndërprerë ndeshjen “

Pra siç mund të vërehet deklaratat e delegatit të ndeshjes dhe referit të parë përputhen në tërësi me njëra tjetrën.

Rjedhimisht, pretendimi ankimorë është i pabazuar.

5. Komisioni disiplinorë nuk ka përfillur sygjerimet e Komisionit Arbitrar

Komisioni Arbitrar thekson se Komisioni Disiplinorë ka përfillur në tërësi vërejtjet e dhëna me Vendimin e datës 26 maj 2015.

Vërejtja kryesore e dhënë Komisionit Disiplinorë kishte të bente me arsyetimin më të mirë të Vendimit, pasi që sipas mendimit të Komisionit për Arbitrazh Komisioni Disiplinorë nuk kishte dhënë arsye për faktet vendimtare dhe se Vendimi që kishte të bente me pezullimin e z. Gazmend Pupovci ishte kundërthënë.

Komisioni Disiplinorë në Vendimin e datës 04.06.2015 ka përshkruar në mënyrë të sakt të gjitha dispozitat normative në të cilat ka mbështetur vendimin e tij, pastaj po ashtu në mënyrë të detajuar ka përshkruar të gjitha deklaratat e akterëve të ndeshjes. Po ashtu Komisioni Disiplinorë në mënyrë të sakt potencoi edhe bazën juridike për suspendimin e z. Gazmend Popovci duke cituar edhe deklaratën e tij të dërguar me email me datën 20.05.2015 , si dhe qëndrimin e tij në cilësinë e personit zyrtarë të ndeshjes KB “Peja” – KB “Sigal-Prishtina se “nuk duam të luajmë” , Komisioni Disiplinorë ka marrë një vendim në përputhje me Rregullorën Disiplinore.

6. Nuk është marrë si rrethanë lehtësuese deklarata e sekretarit gjeneral të KB “PEJA” .

Pretendimi ankimorë i KB “Peja”se nuk janë marrë parasysh rrethanat lehtësuese për z. Gazmend Pupovci është i bazuar.

Handwritten blue stamp with the text "KONFERENCA" and "KONFERENCA" written vertically.

Neni 23 i Rregullorës Disciplinore përcakton se gjatë vendimarrjes Komisioni Disciplinorë duhet të marrë parasysh si rrethanat rënduese po ashtu edhe ato lehtësuese.

Gjithsesi se si rrethanë rënduese duhet të merret parasysh fakti se z.Gazmend Pupovci ka treguar një vendosmëri në kryerjen e shkeljës disiplinore atëherë kur deklaroi prerazi se “nuk duam të luajmë” , por në dritën e vlerësimit të rrethanave rënduese duhet të vlerësohen edhe rrethanat lehtësuese të cilat Komisioni Disciplinorë nuk i ka vlerësuar fare.

Komisioni për Arbitrazhë vlerëson si rrethanë lehtësuese faktin se z. Gazmend Pupovci është punëtorë shumë vjeçarë i basketbollit, se ka dhënë kontributë në basketbollin kosovar, po ashtu i lartëcekuri ka dhënë kontributë edhe në paraqitjet e KB “Peja” në Ligën Ballkanike.


Për dallim të pasojave për Klubin që në bazë të Propozicioneve dhe Rregullorës janë strikte në rastin konkret, neni 58 i Rregullorës Disciplinore lejon fleksibilitet në matjen e denimit për personin që nxitë garuesit për mospjemarrje të ekipeve, apo të lëshojnë fushën e lojës. Denimi minimal i paraparë për këtë shkelje është në afat (6) muajshë. Komisioni është i mendimit se duke marrë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese, e po ashtu edhe ato rënduese z. Gazmend Popovci duhet ti shqiptohet denimi me ndalesë kohore të kryerjës së detyrës në kohëzgjatje prej (6) muajve.

Krejt në fundë vlenë të potencohet se mbledhja e Komisionit për Arbitrazh në shqyrtim të ankesës së KB “Peja” kishte filluar me datën 10 qershor 2015 në përbërje të plotë, ndërsa u vazhdua me datën 15/06/2015 me pjesmarrjen e vetëm dy anëtarëve të Komisionit për Arbitrazhë, pasi që Kryetari z. Halit Muharremi kishte dërguar një email në adresë elektronike të Komesarit të Garave me të cilin kërkoi që mbledhja të mbahet pa prezencën e tij , pasi që ai do të jetë jashtë Kosovës deri me datën 25 qershor 2015. Kryetari z. Muharremi në email prezantoi qëndrimin e tij i cili ishte pro aprovimit të të gjitha pretendimeve ankimore të KB “Peja”.

Duke u nisur nga sa më sipër Komisioni për Arbitrazh vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

z.HALIT MUHARREMI

z. ASDREN HOXHA



TI DËRGOHET:

1X Komisionit Disiplinor,
1 x KB Peja - Pejë
1 x arkivit te FBK-së



z. ARTAN QERKINI

